

**Data 03.04.2024**

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË PUBLIKE- MBI KUFIRIN E LARTE  
MONETAR- PROKURIM ME MJETE ELEKTRONIKE**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 2”**

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për autostrada, rrugë, 45233100-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2,257,611,208.65** (dy miliard e dyqind e pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetë presje gjashtëdhjetë e pesë) **Lekë, pa TVSH.**

**Në Euro : 22,023,326.58** (njëzet e dy milion e njëzet e tre mijë e treqind e njëzet e gjashtë presje pesëdhjetë e tetë) **EUR pa TVSH. (kursit i këmbimit, 1 (një) Euro këmbehet me 102.51 Lekë)**

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për vitin 2024 (*Shkresa e MIE nr. 1707/3 prot, datë 18.03.2024*). Bazuar në Nenin 42, pika 1 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”. Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Ndarja në lote e objektit do të komplikonte rakordimin e punimeve civile dhe proceseve të punës, e për pasojë do sillte risqe të mëdha për përfundimin e veprës në kohë dhe në cilësi.

Në zbatim të pikës 2 të Nenit 56 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Autoriteti Kontraktor do të publikojë njoftimin e kontratës në gjuhën Angleze në gazetën **“TED”** me shpërndarje në Europë.

Në zbatim të pikës 2 Neni 12 i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka konvertuar vlerën limit të kontratës në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë data **03.04.2024, ora 12:23:20**

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1*
- d. *Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2*
- e. *Lista e Informacionit Konfidencial , sipas Shtojcës 4*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:** sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur - punë publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma “a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros*

minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Gjithashtu, është përcaktuar jo më e vogël se vlera e kontratës për të rritur numrin e konkurrentëve në procedurë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

---

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

---

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.**

### **2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore,
  - Aktin e kolaudimit;

**Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore;
  - Akt kolaudimi objekti;

**Shënim:** *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

**2.3.1/2** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

**2.3.1/3** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të Nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

**2.3.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë:

**2.3.2/1** Kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1-E	Punime gërmimi në tokë
2	NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5-F	Punime nëntokësore, ura, vepra arti

4	NP-12-E	Punime inxhinierike mjedisore
5	NS-2-A	Impliante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre
6	NS-6- B	Sinjalistika rrugore jondriçuese
7	NS-7-D	Barriera dhe mbrojtja rrugore
8	NS-18-E	Punime topogjeodezike

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”.*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-E	Punime germimi në tokë	Punime germimi ne trupin e rruges,	201-400 mln	306,660,612.00

		ne vepra arti te vogla, ne rjetin e kanalizimit te ujrave te shiut, ballkonet panoramike, sheshpushim, linjat rezerve etj.		
NP-4-G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Perfshin gjithë punimet ne rruge.	Mbi 800 mln	2,150,105,912.91
NP-5-F	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Punime vepra arti te vogla dhe te medha	401-800 mln	503,950,579.50
NP-12-E	Punime te inxhinierise se mjedisit	Punime mbrojtje skarpatash,mure terramesh, etj	201-400 mln	274,076,385.61
NS-2 – A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre	Punime per tualetet + njesi sanitare	0-20 mln	2,311,616.00
NS-6- B	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Punime sinjalistike vertikale dhe horizontale	21-50 mln	21,721,928.20
NS-7-D	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Vendosje Guardrail	101-200 mln	127,638,775.00
NS-18-E	Punime topogjeodezike	Punime ne trupin e rruges	201-400	215,010,591

**2.3.2/2** Personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet/ Markshaider**
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**

*\*\*\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

*Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuësit teknik të jenë të siguar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

*Kriteri për stafin drejtues teknik lidhet ngushtësisht objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Inxhinierët janë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **200 (dyqind) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën **Tetor 2023 - Mars 2024**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Tetor 2023 - Mars 2024**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Tetor 2023 - Mars 2024**.

**Argumentim:** *Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

*Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre*



në punë me kohështrirje **Tetor 2023 - Mars 2024**, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **të paktën 200 persona**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport) zëri fuqi punëtore zë rreth 20% të kostos.

**2.3.4** Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

**1(nje) Inxhinier Ndertimi (Profili Infrastruktura e Transport)**

**2(dy) Inxhinier Topograf / Gjeodet/Markshaider**

**1(nje) Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik**

**1(nje) Inxhinier Hidroteknik**

**1(nje) Inxhinier Mekanik**

**1(nje) Inxhinier Mjedisi**

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

*Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", si dhe Ligjit nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".*

*Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.*

*Operatori/ët ekonomik/ë që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.*

**2.3.6** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier ndërtimi me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.*

*"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, Librezë pune dhe kontratë pune.***

*Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe bazuar në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim" e ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa" me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të përcaktojnë Drejtuesin Teknik që do jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt.

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 8
3	Kamioncine	në pronësi ose me qira	Copë 3
4	Kamion me vinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Fadrome me goma	në pronësi ose me qira	Copë 3
6	Minifadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Greider	në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 4
10	Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Asfaltoshtuese	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Eskavatore me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 2
15	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Rimorkiator	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Buldozer	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Rrul gome-hekur	në pronësi ose me qira	Copë 2
19	Rrul gome-gome	në pronësi ose me qira	Copë 2
20	Rrul hekur-hekur	në pronësi ose me qira	Copë 2
21	Vibratore	në pronësi ose me qira	Copë 2
22	Makineri vijejimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Makineri per vendosje guardrail	në pronësi ose me qira	Copë 2
24	Freze asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
25	Autokompresor	në pronësi ose me qira	Copë 1
26	Fabrikë Betoni (e paisur me leje mjedisore kodë III.1.B	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
27	Fabrikë asfalti (e paisur me leje mjedisore kodë III.1.B	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1
28	Nyje Inerte (e paisur me leje mjedisore kodë III.1.B	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Cope 1

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.** “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë

- ISO 9001:2015           Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015       Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001:2018       Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga

*një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

#### **2.4.2 Grafiku i punimeve.**

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

**2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).**

*Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve. Financimi është parashikuar në buxhetin 2024-2026, por vlera e parashikuar e kontratës kalon 3 (tre) vjeçarin, edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.*

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

#### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e Nenit 4, pika 38/b dhe Nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose*

*originë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Specifikimet teknike do të hartohen dhe do të argumentohen për çdo zë punimi të kësaj vepre sipas preventivit të hartuar nga projektuesi.*